



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:244231

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06904901

**P.nr.102/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtore profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.H nga Prishtinë, për shkak të veprës penale “*Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës*” nga neni 358 par.5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP.II.nr.1665/23 të datës 17.11.2023, në seancën publike të shqyrtimit për marrëveshjen e pranimit të fajësisë, me datën 11.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Agim Kurmehaj, të dëmtuarave A.J, H.S dhe S.G, mbrojtësit të pandehurit, av. Florim Shefqeti, nga Prishtina, sipas autorizimit, si dhe të pandehurit Sh.H, me datën 13.02.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 25.02.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**SH.H**, i lindur me datë ....., në ....., me vendbanim në rr.“.....”, nr....., në komunën e Junikut, i biri i H. dhe R. e gjinisë ....., i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, me profesion ekonomist, ....., i identifikuar me nr. personal ....., nr. tel. ...., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

*Me dt. 29.05.2023 rreth orës 10:00 në Junik, pikërisht në firmën “.....” SHPK, si person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës nuk ofron pajisjet mbrojtëse për përdorimin e tyre kur është e nevojshme dhe në pajtim me rregullat teknike për sigurinë në vendin e punës, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme e me këtë rrezikon jetën e të dëmtuarve H.S, A.J dhe S.G, në atë mënyrë që, të dëmtuarat ishin të punësuar me kontratë sezonale në firmën e të pandehurit, me datën e lartcekur gjersa të njëjtat ishin në një platformë të improvizuar në një lartësi afro 2 metra, duke e bërë rrallimin e mollave, për shkak të peshës,*

*e humbin ekuilibrin e platformës dhe bien në tokë, ku si pasojë e kësaj e dëmtuara S.G pëson lëndime të rënda trupore, ndërsa të dëmtuarat H.S, A.J pësojnë lëndime të lehta trupore,*

- Me këtë ka kryer veprë penale **“Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës”** nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par. 2 të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43 44, 69, 70, neni 358 par.5, lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, neni 230, 358, 364, 365, 449, 452, 460 të KPRK-së, si dhe marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/II.Nr.1665/2023 e datës 17.11.2023, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje **prej gjashtë (6) muajsh**, i cili dënim me pëlqimin e tij, e në kuptim të nenit 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i është zëvendësuar **ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej **dymijë (2000) euro**, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan brenda afatit të përcaktuar dënimit e shqiptuar me gjobë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.
- IV.** Të dëmtuarat S.G, H.S si dhe Arieta Jahjaga nga Komuna e Junikut, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kërkesë-pasurore juridike.

## **A r s v e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 17.11.2023, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1665/2023, ndaj të pandehurit Sh.H, nga Prishtina, për shkak të veprës penale **“Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës”** nga neni 358 par 5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPRK-së. Së bashku me aktakuzën, prokurori i ka dërguar gjykatës edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e dt.17.11.2023, e lidhur në mes të

kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, të pandehurit Sh.H, mbrojtësit të tij Av.Florim Shefqeti dhe prokurores së çështjes penale.

Fillimisht, kjo çështje penale më parë ka qenë duke u trajtuar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan, mirëpo gjyqtari i çështjes sipas aktvendimit P.nr.280/23 e dt.06.02.2024, është shpallur jo kompetent në pikëpamje territoriale.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes me datën 11.02.2025, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Agim Kurmehaj, të dëmtuarat A.J, H.S dhe S.G, mbrojtësi i të pandehurit, Av.Florim Shefqeti, nga Prishtina, sipas autorizimit, si dhe i pandehuri Sh.H.

Gjatë seancës u shqyrtua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ku sipas marrëveshjes, i pandehuri është pajtuar që për veprën penale “*Asgjësim, dëmtim ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës*” nga neni 358 par.5, lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, t’i shqiptohet dënimi me burgim efektiv në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit konform nenit 44 të KPPRK-së mund të shndërrohet në gjobë dhe atë 1500-2000 euro. Po ashtu i pandehuri është pajtuar që të heq dorë nga e drejta e tij për gjykim dhe gjithë të drejtat e tjera të përshkruara në deklaratën bashkëngjitur marrëveshjes, të cilën e konfirmuan edhe gjatë seancës.

Në kuptim të nenit 230 par.17, të KPPRK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka dëgjuar të pandehurin dhe ka vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale e cila i është vënë në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të paraqitura në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhje të akuzës që parashihet me nenin 248 par.1 të KPPRK-së.

Në kuptim të nenit 230 par.18 të KPPRK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese ka dëgjuar pikëpamjet palëve në procedurë lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë deklaroi se: *mbetem në tërësi pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e pandehurit e cila marrëveshje është arritur pas konsultimeve të mjaftueshme të tij me mbrojtësin e tij, duke i vënë në dijeni së pari veprat e kryera pasojat e veprave dhe dënueshmërinë e tyre.*

Po ashtu, i pandehuri dhe mbrojtësit i tij kanë deklaruar se *mbesin në tërësi pranë marrëveshjes së arritur për pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit.*

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 230 par.17, i KPPRK-së, respektivisht se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, çka e pohoi edhe vet i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës, së pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se nuk ka qenë i shtrënguar

apo i detyruar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, dhe së ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: *Raporti i Oficerit A. Gj. #8663, e datës 30.05.2023; Raporti i shpejtë, i datës 30.05.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin Sh.H, e dt. 30.05.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën S.G, i dt.14.06.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën H.S, i dt.29.06.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën A.J, i dt.29.06.2023; Raporti Mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Gjakovë”, me nr.8226, i dt.29.05.2023; Raporti Mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Gjakovë”, me nr.8233, i dt.29.05.2023; Raporti nga Konsulta Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, me nr. 3690 ; Raporti nga Konsulta Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, me nr. 1680, i dt.28.07.2023 ; Raporti Mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, me nr. 3226, i dt.29.05.2023; Raporti Mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, me nr. 823, i dt.29.05.2023; 3 (tri) fotografi ku shihet vendpunimi i të dëmtuarave; Art Ekspertimi Mjeko Ligjor i datës 29.09.2023; marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.1665/2023 e datës 17.11.2023, si dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë tjetër e paraparë me nenin 248 par.1 të KPPRK-së.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i Shtetit Agim Kurmehaj, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të mirët pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës dhe të njëjtit ti përcaktohet dënimi me gjobë siç është përcaktuar në marrëveshje ndërkaq në kuadër të rrethanave rënduese të mirët ndonjë dënim eventual i mëparshëm i të pandehurit.*

E dëmtuara A.J ka deklaruar se: *nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, nuk dëshiroj që i pandehuri të dënohet.*

E dëmtuara H.S ka deklaruar se: *nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, nuk dëshiroj që i pandehuri të dënohet.*

E dëmtuara S.G ka deklaruar se: *nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, nuk dëshiroj që i pandehuri të dënohet.*

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Florim Shefqeti, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese ka deklaruar se: *kërkojmë nga gjykata që të bëjë shqyrtimin e gjobës në shumën prej 1500 euro sipas marrëveshjes duke vlerësuar që nga deklarimi i prokurorit të shtetit për të gjitha rrethanat lehtësuese, po ashtu të dëmtuarat nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk paraqesin kërkesë pasurore juridike, në bazë të KPK-së nenit 70 par. 3, 10 dhe 11 lidhur me nenit 71 dhe 72 janë plotësuar kushtet e po ashtu pagesa e kësaj gjobe të lejohet në tri deri në pesë këste duke qenë se nga të ardhurat e tij i pandehuri mban familjen e tash së voni ka edhe një fëmijë të vogël e që nevojitet edhe kujdes në aspektin financiar.*

I pandehuri Sh.H, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që e kam kryer i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, nuk kam qene i dënuar me parë me aktgjykim të formës së prerë, më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur dhe menjëherë kemi marrë masa pas rastit që i njëjti të mos përsëritet.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprës penale *“Asgjësim, dëmtim ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës”* nga neni 358 par.5, lidhur me par.3 lidhur me parag.2 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese: marrëveshjen mbi pranim e fajësisë të lidhur në mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ku i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij, premtimin gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, faktin se nuk ka qenë i dënuar me parë me aktgjykim të formës së prerë, gjykata pati parasysh edhe faktin se pas rastit të ndodhur ka marrë masa që i njëjti rast të mos përsëritet, si dhe sjelljet e tij pas rastit ku iu ka ofruar ndihmë për shërim të dëmtuarave, po ashtu edhe faktin se të dëmtuarat **S.G**, **H.S**, dhe **Arieta Jahjaga**, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kërkesë-pasurore juridike, ndërsa rrethana rënduese gjykata përveç elementet inkriminuese të figurës së veprës penale në rastin konkret nuk gjeti, andaj duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobë u mor në përputhje me nenin 40 par.1 pika 1.3, e lidhur me nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së, e po ashtu me nenin 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 i KPRK-së ku përveç që përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, dënim me burgim deri në pesë (5) vjet, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e pas parasysh edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë,

gjkata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6), i cili dënim me pëlqimin e tij e konform nenit 44 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, ia ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën e përcaktuar si në pikën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe kjo pasi që i pandehuri ka dhënë pëlqim për një gjë të tillë.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon, refuzon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPK-së. Vendimi lidhur me Taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, është marrë konform nenit 36 par. 3, pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit – 08/L-109.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 460 të KPPRK-së, pasi që të dëmtuarat S.G, me vendbanim në lagjen e ....., Komuna e Junikut, H.S, me vendbanim në Lagjen ....., Komuna e Junikut dhe Arieta Jahjaga, me vendbanim në Lagjen ....., Komuna e Junikut, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kërkesë-pasurore juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në mbështetje të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.102/24, me datën 25.02.2025.**

**Bashkëpunëtore profesionale:**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese:**

\_\_\_\_\_  
**Leonita Lajçi-Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.